

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-6/09

Prishtinë, 9 Qershor 2011

S.A.

Ankuesi

I përfaqësuar nga avokati X.B.

vs.

M.M.

Paraqitësi i kërkesës/Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Ankesave i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga Antoinette Lepeltier-Durel, kryetare, Anne Kerber dhe Sylejman Nuredini, gjyqtarë, në ankesën ndaj vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/22/2008, (lënda është regjistruar në AKP me numrat KPA 39606 dhe KPA 39607), të datës 28 Gusht 2008, pas shqyrtimit të mbajtur me 9 Qershor 2011, mori këtë

AKTGJYKIM

- 1- Ankesat e ushtruara nga S.A. të regjistruara nën numrin GSK-KPA-A-6/09 dhe GSK-KPA-A-7/09 janë bashkuar si një lëndë e vetme nën numrin GSK-KPA-A-6/09.
- 2- Ankesa e parashtruar nga S.A. me datë 15 Shtator 2009 është refuzuar si e palejueshme.

- 3- Shpenzimet e procedurës të përcaktuara në shumë prej 60 Eurosh (gjashtëdhjetë euro) do t'i paguhen Gjykatës Supreme nga ankuesi, brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

Zhvillimet procedurale dhe faktike:

Paraqitësja e kërkesës M.M. ka paraqitur kërkesë për të drejtë pronësie me 11 Maj 2007 në AKP, duke kërkuar që ngastrat kadastrale 867/1 dhe 867/2, që ndodhën në vendin e quajtur “Velika Njiva”, në zonë kadastrale të Kolovicës, komuna e Prishtinës, të kualifikuara si fusha të klasës së III-të me sipërfaqe përkatëse prej 0.36.10 hektar dhe 0.03.54 hektar, t’i kthehen në posedim dhe shfrytëzim, dhe që të ndalohet çdo tjetërsim i këtyre pronave dhe që ajo të kompenzohet për shfrytëzim të pronave pa leje. Ajo ka pohuar se babai i saj i ndjerë ka qenë pronar i ngastrave dhe se ajo kishte humbur posedimin e pronës së paluajtshme bujqësore me 12 Qershor 1999 si rezultat i konfliktit që ka ndodhur me 1998/1999.

Paraqitësja e kërkesës ia ka paraqitur AKP-së vendimin për trashëgiminë O. nr. 5/96 të datës 12 Shkurt 1996, të lëshuar nga Gjykata Komunale në Prishtinë lidhur me ngastrat kadastrale nr. 867/1 dhe nr. 867/2 në Kolovicë. Me anë të këtij aktgjykimi është vërtetuar se M.M., e bija e të ndjerit S.N., i cili kishte vdekur me 4 dhjetor 1989 dhe i cili ishte trashëgimtar i 1/6 të pjesës ideale të trashëgimisë së përgjithshme, i cili përfshin edhe ngastrat kontestuese, motrat dhe vëllezërit e saj kanë qenë trashëgimtarë të pjesëve të mbetura ideale. Po ashtu, ajo ka paraqitur fletën posedues nr. 66 të zonës kadastrale të Kolovicës të datës 22 Korrik 2003, certifikatën e saj të martesës të datës 24 Nëntor 1980 dhe certifikatën e vdekjes së S.N. të datës 17 Nëntor 2006. Së fundi, ajo ka ofruar aktgjykimin P. nr. 86/03 të lëshuar nga Gjykata Komunale në Prishtinë me 10 Qershor 2007, mbi vendosjen e kërkesëpadisë së saj dhe të motrave të saja si paditës kundër vëllezërve të tyre T.N. dhe S.N.. Ky aktgjykim ka të bëjë me ngastrat e ndryshme nga ato që janë objekt i çështjes në lëndët e tanishme.

Sekretaria Ekzekutive e AKP-së ka vazhduar me njoftimin e kërkesës me 19 Shkurt 2008. Pasi që nuk është gjetur ndonjë mbajtës i pronës, ajo ka vendosur nga një pllakatë në çdo ngastër. Pastaj ka publikuar kërkesën me 9 Prill 2008. Asnjë palë përgjegjëse nuk është lajmëruar në Sekretarinë Ekzekutive para skadimit të afatit prej 30 ditësh pas datës së publikimit.

Paralelisht, Sekretaria Ekzekutive ka vazhduar me verifikimin e dokumenteve të paraqitura nga paraqitësja e kërkesës. Ky verifikim ka qenë pozitiv për secilin prej tyre. Sa i përket fletës poseduese nr. 66 të zonës kadastrale të Kolovicës, një version i azhurnuar i datës 31 marsh 2008 është përfshirë në dosje. Ajo ende cek S.N. si posedues i ngastrave kontestuese.

Komisioni i Kërkesave Pronësore të Kosovës (KKPK ose Komisioni) nëpërmjet vendimit KPCC/D/A/22/2008 të datës 28 Gusht 2008, në përputhje me nenin 11.3 (a) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 për Zgjidhjen e Kërkesave që kanë të bëjnë me Pronën e Paluajtshme Private, duke përfshirë Pronën Bujqësore dhe Komerciale dhe nenin 8.6 (a) të Shtojcës III të Urdhëresë Administrative (UA) 2007/5 për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, të ndryshuar nga i njëjti ligji, ka vendosur që të pranojë kërkesën pronësore të M.M.. Si rezultat asaj i është dhënë ri-posedimi në ngastrat kadastrale 867/1 dhe 867/2. Gjithashtu, me anë të këtij vendimi pala përgjegjëse ose ndonjë person tjetër që mund t'i ketë uzurpuar këto prona është urdhërua që t'i lirojë ato brenda 30 ditësh nga dita e dorëzimit të urdhëresës. Në paragrafin (d) të vendimit të njëjtë është vendosur se nëse pala përgjegjëse apo ndonjë person që ka uzurpuar pronat nuk vepron në pajtim me këtë urdhëresë, atëherë ata do të largohen me forcë nga aty. Kërkesat për kompensim për humbje të shfrytëzimit janë refuzuar për arsye se Komisioni nuk ka pasur kompetencë për të vendosur rreth kësaj.

Me 19 Mars 2009, paraqitësja e kërkesës ka konfirmuar se sa asaj i është dorëzuar vendimi i KKPK-së.

Mbajtësit të tanishëm të ngastrës kontestuese i është dorëzuar vendimi me 21 Gusht 2009. Pranimi ka përmendur si të adresuar "Z.A."

Me 15 Shtator 2009, S.A. ka paraqitur kërkesë brenda afatit të paraparë në nenin 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, i cili parasheh se pala mund të paraqes ankesë kundër një vendimit Komisionit në Gjykatën Supreme të Kosovës nëpërmjet Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës brenda tridhjetë (30) ditëve nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi.

Nënshkrimi i pranimit të njoftimit të vendimit të KKPK-së dhe të ankesës janë qartazi të njëjtë.

Ankuesi ka paraqitur ankesë mbi bazat e mëposhtme të parapara në nenin 12.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079: shkeljes esenciale të së drejtës

procedurale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike zbatimit jo të drejtë të së drejtës materiale. Ai ka propozuar që të ndryshohet vendimi i kundërshtuar i KKKP-së dhe të refuzohet kërkesa pronësore si a pabazuar apo të anulohet vendimi dhe të dërgohet lënda për rigjykim në Komision..

S.A. ka pohuar se ngastrat në fjalë i janë shitur babait të tij Z.A. nga S.N. në vitin 1982 dhe që nga ai vit e deri në vdekjen e babait të tij me 11 Nëntor 1994, dhe pastaj ai ka qenë vetë në posedim dhe shfrytëzim të kësaj toke. Ai ka shtuar se kontrata e shitblerjes nuk është certifikuar dhe prona nuk është regjistruar për shkak të ligjeve diskriminuese të asaj kohe që parandalonin çdo transaksion ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve. Ai ka paraqitur 4 fletëpagesa të datës 22 Qershor dhe 4 Nëntor 1982, 4 Janar 1983 dhe 27 Shkurt 1984 të cilat tregojnë se një shumë e caktuar e parave i është dhënë S.N. nga babai i tij për blerjen e arës së punueshme me sipërfaqe prej 100m² pa përmendur ndonjë numër të ngastrave të shitura. S.A. po ashtu ka ofruar dy deklarata, njëra e nënshkruar nga T.N. dhe tjetra e nënshkruar nga Slobodan dhe N.N., respektivisht bijtë dhe nipi i S.N.. Së fundi ai ka paraqitur një kopje të kërkesës të cilën e ka parashtrua me 7 Korrik 2008 në Gjykatën Komonale të Prishtinës kundër S. dhe S.N. me qëllim të kërimit të njohjes së të drejtave të tij pronësore. Sipas tij, kjo procedurë gjyqësore është në vazhdim e sipër. Kjo kërkesë tregon se ajo ka të bëjë me ngastrën nr. 867/1, fleta posedues nr. 66 e zonës kadastrale të Kolovicës dhe me ngastrën nr. 186 të zonës kadastrale të Kolovicës me sipërfaqe prej 17.03 ari. Nuk është paraqitur asnjë kontrate me shkrim e shitblerjes.

Ndonëse të ankuarit i është dorëzuar ankesa me 5 Nëntor 2009, siç dëshmohet nga pranimi me anë të postës së regjistruar të dërguar nga Sekretaria Ekzekutive, ajo nuk ka paraqitur ndonjë përgjigje.

Arsyetimi ligjor:

Bashkimi i ankesave:

Neni 13.4 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligin nr. 03/L-079 për zgjidhjen e kërkesave që kanë të bëjnë me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale parashih që Gjykata Supreme mund të vendos sipas ankesave të bashkuara apo të konsoliduara kur një bashkim apo konsolidim i tillë është vendosur nga Komisioni në përputhje me nenin 11.3 (a) të rregullores së njejt. Neni i fundit i përmendur ia mundëson Komisionit t'i bashkojë apo konsolidojë kërkesat me qëllim të shqyrtimit të tyre dhe marrjes së vendimeve lidhur me to në rast të shqyrtimit të çështjeve të përbashkëta ligjore dhe procedurale.

Sa i përket dispozitave të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore nr. 03/L-079 (LCP) të cilat zbatohen në procedurën e apelimit para Gjykatës Supreme në pajtim me nenin 12.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, neni 408 paragrafi 1, në lidhje me nenin 193 parasheh që ankesat mund të bashkohen në një padi nëse një bashkim i tillë kontribuon në efikasitetin e procedurës.

Në rastin konkret, ankuesi ka parashtruar vetëm një ankesë, duke dhënë në mënyrë joshprehimore pëlqimin e tij për bashkimin e lëndëve, ashtu siq parashihet me nenin 408.3 të LPK-ës. Pala përgjegjëse në ankesë nuk e ka kundërshtuar këtë. Më tutje, Gjykata Supreme vëren se faktet, baza ligjore dhe çështjet e provave janë saktësisht të njëjta në të dy rastet. Vetëm ngastrat, që janë objekt i së drejtës pronësore të pretenduar në secilën kërkesë, janë të ndryshme. Ankesat bazohen në të njëjtën deklaratë sqaruese dhe në të njëjtin dokumentacion. Për më tepër, KKPK-ja mbulon vendimin që është kundërshtuar në të njëjtin rast.

Pasi që të gjitha elementet e gjertanishme të këtyre rasteve janë të njëjtat përveç ngastrave, është qartazi më efikase të bashkohen ankesat dhe ato të shqyrtohen në një aktgjykim të vetëm.

Lëndët e regjistruara nën numrat GSK-KPA-A-6/09 dhe GSK-KPA-A-7/09 janë e njëjta lëndë me numër GSK-KPA-A-6/09.

Pranueshmëria e ankesave:

Gjykata Supreme konstaton se S.A. nuk lejohet parashtrim i ankeses ndaj vendimit të KKPK-së.

Sipas nenit 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, pala mund të paraqes ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e njoftimit të vendimit.

Në përputhje me 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, ka të drejtë ankese dhe procedura përkatëse është *“Çdo person, përveç parqitësit të kërkesës, i cili aktualisht ushtron ose pretendon se ka të drejtë në pronën e cila është objekt i kërkesës ose çdo person tjetër i cili mund të ketë ndonjë interes ligjor në pronën ndaj së cilës është parashtruar kërkesë është palë në këtë kërkesë dhe në procedurat e përafërta, me kusht që personi i tillë ta informojë Sekretarinë ekzekutive për qëllimin e tij që të marrë pjesë në procedurën administrative brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi për kërkesën nga Sekretaria ekzekutive në pajtim me nenin 10.1”.*

Për më tepër, në përputhje me nenin 10.3 të Rregullorës së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079: *“Personi me interes ligjor në kërkesë i cili nuk ka marrë njoftimin mbi kërkesën mund të pranohet si palë kurdoqoftë gjatë procedurës.”*

Këto dispozita, të cilat në këtë mënyrë iu përmbahen parimeve të zakonshme ligjore dhe sidomos nenit 186 paragrafi 3 të LPK-ës, sjellin ndërmend se e drejta në ankesë i përket një pale në procedurë në shkallë të parë. Në mënyrë më të veçantë, ato parashohin se mungesa e njoftimit të kërkesës mund ta shpie gjykatën që ta pranojë një palë me interes ligjor në çdo kohë gjatë procedurës.

Në rastin konkret, S.A. nuk ka qenë palë në procedurën në shkallë të parë ndonëse ai është njoftuar me kohë në lidhje me kërkesën.

S.A. nuk e ka njoftuar Sekretarinë Ekzekutive për qëllimin e tij për të marrë pjesë në procedurë ndonëse procesi i njoftimit është kryer në përputhje me nenin 10.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me ligjin. 03/L-079 i cili parasheh që Sekretaria Ekzekutive duhet të bëjë përpjekje të arsyeshme për ta bërë njoftimin e kërkesës, duke përfshirë edhe publikimin e saj. Në rastin konkret, Sekretaria Ekzekutive nuk ka mundur ta gjejë adresën e mbajtësi në kohën e procesit të njoftimit, kështu që, ka vendosur një pllakat në ngastra e cila përmban njoftimin e 19 Shkurtit 2008, pastaj e ka publikuar atë me 9 Prill 2008.

Gjykatat Supreme e Kosovës vëren se S.A. nuk ka përmendur ndonjë arsye për të justifikuar se nuk ka mundur të njoftohet për kërkesën. Pasi që, S.A. ka pohuar në ankesën e tij se babai i tij i kishte blerë ngastrat kontestuese në vitin 1982 dhe se ai gjendet në posedim dhe shfrytëzim të ngastrave kontestuese që nga vdekja e babait të tij në vitin 1994, ai nuk ka mundur mos t'i ketë parë pllakatat në ngastrat të cilat ai pretendon t'i punojë. Fotografitë dhe skema e paraqitur nga Sekretaria Ekzekutive tregojnë se ngastrat e vogla në fjalë janë afër njëra tjetrës dhe ndodhen përgjatë rrugës afër zonës së banuar. Ato nuk janë ngastra të papunuara të pyllit shumë lart nga zona e banuar. Derisa i ka punuar ato, S.A. ka mundur t'i gjejë shenjat e dukshme të vendosura në arë.

Gjykata Supreme konkludon se lajmërimi është bërë në atë mënyrë që ia ka mundësuar mbajtësit të paraqes mbrojtjen e tij me kohë. Për më tepër, Gjykata Supreme vëren se mbajtësi ka pasur kohë shtesë për ta bërë atë pasi që afati 30 ditor për përgjigje ka filluar nga data e publikimit të kërkesës e cila ka ndodhur 2 muaj dhe 10 ditë pas njoftimit.

Prandaj, S.A. nuk i lejohet parashtrimi i ankeses. Gjykata Supreme duhet ta konsideron ankesën e tij si të palejueshme.

Shpenzimet e procedurës:

Në përputhje me nenin 8.4 të Shtojcës III, të Urdhëresës Administrative (UD) 2007/5 e ndryshuar nga Ligji nr: 03/L-079, palët përjashtohen prej shpenzimeve të procedurës që zhvillohet para Sekretariatit Ekzekutiv dhe Komisionit.

Megjithatë një përjashtim i tillë nuk parashihet edhe për procedurën para Gjykatës Supreme.

Rrjedhimisht, regjimi normal i shpenzimeve gjyqësore siç parashihet me Ligjin mbi Shpenzimet Gjyqësore (Gazeta Zyrtare e KSAK, 3 tetor 1987) dhe sipas UD Nr:2008/2 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi Unifikimin e Shpenzimeve Gjyqësore, zbatohet ndaj procedurës së zhvilluar para Gjykatës Supreme..

Prandaj, shpenzimet gjyqësore si në vijim aplikohen në procedurën e tanishme të ankesës:

- Tarifa e taksës gjyqësore për paraqitjen e ankesës (Neni 10.11 i UA 2008/2): 30 €
- Tarifa e taksës gjyqësore për marrjen e aktgjykimit (Nenet 10.15, 10.21 dhe 10.1 të UA 2008/2), duke pas parasysh se vlera e pronës në fjalë mund të vlerësohet me arsye mbi 5.001 €: 30 €.

Këto taksa gjyqësore do të bartën nga ankuesi i cili e humb rastin.

Në përputhje me nenin 45 paragrafi 1 të Ligjit mbi Shpenzimet Gjyqësore, afati për pagesën e tarifave në fjalë është 15 ditë nga dita e dorëzimit të aktgjykimit. Si pasojë e mospagesës brenda afatit urdhërohet përmbarimi i detyrueshëm duke përfshirë gjobën e paraparë në nenin 47 të të njëjtit ligj.

Këshillë juridike

Në përputhje me Nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

Nënshkruar nga: Antoinette Lepeltier-Durel, Kryetare e Kolegjit, EULEX

Nënshkruar nga: Anne Kerber, Gjyqtare e EULEX-it

Nënshkruar nga: Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Nënshkruar nga: Urs Nufer, Referent i EULEX-it